



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

C-III-12-1327

Paditësi

Z.A.G. nga Prizreni, të cilin e përfaqëson avokat, H.L.

Kundër

E paditura

KBI, Prizren, të cilën e përfaqëson **Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)** “Illir Konushevci” 8, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (“DHPGJS”), Kolegji i përbërë nga Gazmend Sylaj, gjyqtar kryesues, Diellza Hoxha dhe Teuta Ibrahim, gjyqtar, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 30 Shtator 2019, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

1. Padia e paditësit me të cilën kërkohet anulimin e kontratës mbi ndërrimin e paluajtshmërisë Leg. nr. 1340/1967 të datës 13 nëntor 1967 si dhe të drejtën e pronësisë së ngastrës kadastrale nr. 699, në sipërfaqe prej 01.04.91 ha, zona kadastrale , REFUZHET.
2. Propozimi i paditësit që të obligohet AKP që paraprakisht të informoj personalisht paditësin mbi tenderimin e ngastrës kadastrale nr. 699, në sipërfaqe prej 01.04.91 ha, zona kadastrale , HUDHET.
3. Nuk caktohen taksat gjyqësore.

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me 29 qershor 2006, paditësi parashtrij padi pranë Gjykatës Komunale në Prizren - GJKP (tani gjykata themelore).

Paditësi fillimisht përfaqësohej nga avokati , nga Prizreni.

Paditësi kërkohet anulimin e kontratës mbi ndërrimin e paluajtshmërisë, Leg. nr. 1340/1967 të datës 13 nëntor 1967, e lidhur në mes të paditurës dhe paditësit (kontrata kontestuese).

Paditësi më tutje kërkoj të drejtën e pronësisë së ngastrës kadastrale nr. 699, në vendin e quajtur "A", në sipërfaqe prej 01.04.91 ha, ngastër kjo e evidentuar sipas listës poseduese nr. 154, Zona kadastrale (prona kontestuese). Paditësi përfundimisht kërkoj që prona kontestuese, pranë drejtorisë për kadastër, të evidentohet në emër të tij.

Paditësi propozoj që secila palë ti bart shpenzimet procedurale.

Paditësi pohon se nga pushteti i atëhershëm ishte i detyruar të nënshkruaj kontratën kontestuese, pa vullnetin e tij, me anë të presionit dhe metoda të ndryshme të ndikimit psikik.

Padisë i janë bashkangjitur:

- Kopja e kontratës mbi ndërrimin e paluajtshmërisë, Ov.br. 1340/1967 e datës 13 nëntor 1967.
- Kopja e planit e pronës kontestuese, e datës 20 mars 2006.
- Kopja e listës poseduese, nr. 116, e datës 26 tetor 2005, lidhur me ngastrën kadastrale nr. 359/3, zona kadastrale Atmaxhë.

GJKP me aktvendimin e saj, C.nr. 532/06 të datës 31 maj 2012, shpallet jokompetente dhe lëndë e referon pranë DHPGJS.

Lënda regjistrohet pranë DHPGJS me 27 korrik 2012.

Me urdhërin e datës 27 gusht 2018, AKP u urdhërua që të parashtrij përgjigjen në padi.

Me 31 gusht 2018, AKP parashtrij përgjigjen në padi.

AKP e kundërshtoj padinë në tërsi. Sipas AKP pretendimet e paditësit janë në kundërshtim me dispozitat ligjore, si ato të, Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Ligjit mbi mardhëniet pronësoresh juridike, Ligjit mbi Mardhëniet e Detyrime si dhe Ligjit mbi AKP. Nga gjitha arsyet e cekura në përgjigje propozon që padia të hudhet poshtë apo të refuzohet si e pabazuar.

Me urdhërin e datës, 10 tetor 2018, përgjigja e AKP ju servua përfaqësuesit të paditësit.

Me 26 tetor 2018, përfaqësuesi i paditësit parashtrij përgjigjen në përgjigje.

Paditësi e kundërshtoj përgjigjen e AKP në tërsi dhe mbeti pranë padisë.

Përgjigja e paditësi me urdhërin e gjykatës ju dorëzua AKP, për kundërpërgjigje.

AKP me kundërpërgjigjen e saj të datës 5 nëntor 2018, mbeti në tërësi pranë mbrojtjes – përgjigjes në padi.

Me urdhëresën e KS, palët u ftuan për pjesmarrje në seancën ndëgjimore të caktuar për datën 17 shtator 2019, me fillim në ora 09.30.

Në seancë prezentuan paditësi me përfaqësuesin e tij, avokat H.L., si dhe përfaqësuesi i AKP.

Paditësi mbeti në tërsi pranë padisë dhe propozoj që të aprovet si e bazuar. Paditësi gjithashtu propozoj që gjykata të obligon AKP që të informoj personalisht paditësin lidhur me datën dhe kohën e tenderimit të pronës kontestuese.

Përfaqësuesi i AKP mbeti në tërsi pranë mbrojtjes në padi dhe propozoj që padia të refuzohet si e pabazuar. Përfaqësuesi i AKP kundërshtoj propozimin e paditësit mbi obligimin e saj që të informon paditësin, mbi datën dhe kohën e tenderimit.

Arsyetimi Ligjor:

Nuliteti i kontratave

DHPGJS-ja ka pranuar shumë kërkesëpadi të ngjajshme(kërkesa për anulimin e një kontrate apo kërkesë për shpalljen e kontratës të nule apo të pavlefshme) për kontratat e lidhura në të 1950 gjer 1970 në mes të një personi privat - ish pronari të një ngastre të tokës dhe një NSH/ NP/ dhe institucioni shtetëror. Në shumicën e rasteve, paditësi (-it) është (janë) pasardhësit e ish pronarit.

Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së ka vendosur në disa ankesa lidhur me vendimet e shkallës së parë të kolegjit të specializuar të DHPGJS lidhur me kërkesat për anulimin e kontratave të së njëjtës natyrë.

Për sa i përket zbatueshmërisë së ligjeve, nga Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së është vendosur që (shkurtimisht):

- Neni 8 a i Ligjit për Transferimin e Pronës së Paluajtshme të vitit 1981 (i referuar edhe si Ligji mbi pasurinë e paluajtshme) asnjëherë nuk ka qenë i zbatueshëm në Kosovë .

“Ligji i Serbisë së asaj kohe, nuk ka mund të jetë i aplikueshëm në Kosovë, deri në fund të viteve 80-ta, kur u ndryshua dhunshëm edhe statusi i Kosovës nga pushteti i atëhershëm serb. Deri në këtë periudhë, asnjë ligj i Serbisë, nuk zbatohet në Kosovë, sepse Kosova kishte ligjet e veta, ndërsa kjo dispozitë e nenit 8 ishte ndryshuar vetëm në Ligjin e Serbisë.” (aktvendimi AC-I-13-0114-A001 i lëshuar me 11 dhjetor 2014, faqe 5).

-Ligji për Marrëdhëniet e detyrimeve i vitit 1978 nuk ka fuqi prapavepruese.

“Në këtë lëndë paditësit në padinë e tyre pretendojnë se kontrata e shitblerjes është lidhur në vitin 1964. LMD-ja në bazë të nenit 1109, ka hyrë në fuqi me 1 tetor 1978. Në bazë të nenit 1106 të LMD-së te dispozitat kalimtare, ky ligj nuk do të zbatohet në marrëdhëniet e detyrimeve, të cilat kanë ekzistuar para se ky ligj të hynë në fuqi. Rrjedhimisht LMD-ja nuk lejon veprim retroaktiv të dispozitave të tij për ngjarjet dhe veprimet ligjore të palëve nga viteve 60-ta, kur është lidhur kontrata e shitblerjes e cila po kontestohet. Mbi këtë bazë të këtyre arsyeve, ky ligj në këtë lëndë nuk mund të aplikohet.” (aktvendimi AC-I-13-0114-A001 i lëshuar më 11 dhjetor 2014, faqe 6).

- Nuk ekziston asnjë bazë ligjore në legjislacionin e Kosovës për anulimin e një kontrate të kësaj natyre.

“Rrjedhimishtë Kolegji i Apelit konkludon se Kosova ende nuk ka një ligj për këthimin e tokave ish- pronarëve, andaj nuk ka bazë ligjore e cila mund të aplikohet në bazë së cilës mund të kërkohet kthimi i tokave tek ish-pronarët, apo anulimi i kontratave të lidhura dhe të vërtetuara në gjykata, para 1 tetorit 1978, kur ka hy në fuqi LMD.” (aktvendimi AC-I-13-0114-A001 i lëshuar më 11 dhjetor 2014, faqe 7)

Legjislacioni kosovar nuk përfshin një Ligj për kthim i cili merret me kompensimin e tokës të marrë nga organet shtetërore, pas Luftës së Dytë Botërore.

Andaj KS konstaton se padisë mbi anulimin e kontratës së lidhur me 1967 i mungon baza ligjore.

Andaj u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Kërkesa e paditësit për informim personal lidhur me procesin e tenderimit

Kompetenca lëndore e DHPGJS, është e përcaktuar me nenin 5.1 të Ligjit për DHPGJS (ligji nr. 06/L-086).

Sipas dispozitës së lartëcekur, jurisdikcioni i DHPGJS ndërlidhet lidhur me ndonjë veprim (kundërshtimi ndaj një vendimi, refuzimi për të kryer një akt apo për të përmbushur një obligim, për humbjet financiare që pohohen të jenë shkaktuar nga një vendim, kërkesa kundër një Ndërmarrjeje) apo mosveprim (kërkesa që pretendojnë një të drejtë mbi pronën, të një liste zyrtare të punëtorëve, kërkesa në lidhje me likuidimin etj.) për më tepër obligimet e AKP në kuadër të fushveprimit të drejtave dhe detyrimeve të saj.

Për më tepër sipas Ligjit mbi AKP (neni 49) rregullohet mënyra e njoftimit dhe shpalljeve e që në rastin konkret do të duhej të aplikohesh edhe për paditësin.

Andaj, në pajtim ne nenin 36 paragrafi 2.1, u vendos si në dispozitiv.

Shpenzimet

Taksa gjyqësore është paguar me rastin e parashtrimit të padisë pranë GJKP.

Andaj u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Këshillë juridike

Në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS, apeli kundër këtij aktvendimi parashtrohet me shkrim për Kolegjin e Apelit të DHPGJS në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e marrjes së këtij aktvendimi. Afati i përcaktuar kohor fillon në mesnatën e ditës, kur pala përkatëse ka marrë vendimin me shkrim. Ankesa së bashku me Aktvendimin e ankimuar duhet gjithashtu të dorëzohet tek palët tjera nga Ankuesi, brenda të njëjtit afat kohor.

Në pajtim me nenin 9 paragrafi 8 i Ligjit për DHPGJS, në rast se pala parashtron ankesën, pala tjetër e procedurës mund të dorëzojë përgjigje prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, që nga data e dorëzimit të apelit tek ajo, duke parashtruar përgjigjen tek ankuesi dhe palëve tjera (nëse ka),

Siç përcaktohet në nenin 68 paragrafi 1.2, lidhur me nenin 38.3 të Ligjit për DHPGJS, parashtruesi i ankesës ka shtatë (7) ditë afat, pas dorëzimit të përgjigjejes ndaj ankesës së tij, të parashtrorë përgjigjen e tij ndaj asaj përgjigjeje tek Kolegji i Apelit dhe ta dorëzojë atë tek pala tjetër.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar Kryesues,

Diellza Hoxha, Gjyqtare,

Teuta Ibrahim, Gjyqtare
